



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_ г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i panjohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 71-të, të mbajtur më 30.06.2022, morri vendimin vijues:

## VENDIM

Denoncimi i regjistruar me numër 12-1379/1 të datës 22.02.2020 me pretendime kundër drejtorit të -----për shkelje të të drejtave gjatë zbatimit të shpalljes publike për punësim të punonjësve të shpallur në shkurt të vitit 2020, HIDHET POSHTË.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprime kompetente të mëtejshme sepse ndaj pretendimeve në lëndë veprori organi tjetër kompetent.

Lënda me numër 12 -1379 të datës 13.10.2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

## Arsyetim

Nga një parashtrues i njohur -----nga ----- është dorëzuar denoncim i regjistruar me numër 12-1379/1 me pretendime kundër drejtorit të -----për shkelje të të drejtave gjatë zbatimit të shpalljes publike për punësim të punonjësve të shpallur në shkurt të vitit 2020.

Në rastin konkret, bëhet falë për Shpallje publike për punësim të 4 (katër) punonjësve social nr.1/2020 të datës 03.01.2020 e shpallur në gazetate ditore Nova makedonija dhe Koha, e publikuar nga ----- . Parashtruesi konsideron se drejtori i institucionit publik shëndetësor në fjalë ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme dhe ka keqpërdorur dhe ka shkelur dispozitat ligjore, konkretisht nenin 212 paragrafi 13 i Ligjit për Mbrojtjen Sociale, ku parashikohet se afati për paraqitje është së paku 3 ditë pune si dhe paragrafin 14 të Ligjit për Mbrojtjen Sociale sepse Komisioni Përzgjedhës që ai e themeloi ishte i formuar në mënyrë të parregullt dhe në të ishte emëruar një person që nuk kishte statusin të ofrimit të shërbimeve publike, por ishte person me nivel më të ulët të arsimit dhe ishte i punësuar si personel teknik. Po ashtu

shprehen dyshime se Komisioni Përzgjedhës ka ekzistuar vetëm formalisht për të legjitimuar funksionimin e paligjshëm të drejtorit dhe diskriminimin në procedurë. Kërkohet që të hetohen pretendimet në fjalë dhe të merren masat përkatëse për rastin në fjalë dhe të njoftohen inspektoratet përkatëse.

Nga mbikëqyrja e dokumentacionit që i bashkëlidhet denoncimit të dorëzuar, KSHPK-ja konstaton se për lëndën është zhvilluar procedurë administrative pranë Komisionit Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe procedurën e punësimit të shkallës së dytë, në të cilën është miratuar Aktvendimi me nr. 0904-61 të datës 02.06.2020 dhe i njëjti i është dorëzuar parashtruesit të denoncimit.

Me rastin e procedimit të denoncimit në fjalë, KSHPK-ja konstaton se në rastin konkret ka vepruar organi tjetër kompetent që është kompetent për të vepruar në këtë fushë - Komisioni Shtetëror për Vendimmarrje në Procedurën Administrative dhe në Procedurën e Punësimit në shkallë të dytë, pas së cilës gjykoj se nuk ka elemente për veprim kompetent në këtë rast dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT

Nënkryetar  
Nuri Bajrami

Përgatiti: J.C.

Miratoi: Mr.VG, anëtar i KSHPK-së

